



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 63.11 të ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe duke u bazuar në vendimin e PZAP-së, nr. ZL.Anr.1114/2017, si dhe vendimin e Gjykatës Supreme AA.nr.55/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 02.12.2017, nxjerrë këtë:

VENDIM

Për Përsëritjen e Votimit për Zgjedhjet e Raundit të Dytë për Kryetar Komune në Istog

- I. Miratohet përsëritja e votimit, për zgjedhjet e Raundit të Dytë për Kryetar Komune në Istog.
- II. KQZ-ja vendosi që rivotimi në komunën e Istogut, si në pikën I të këtij vendimi, të mbahet me datën 17.12.2017.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- VI. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 02.12. 2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka

